



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2024:183045
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06572462

C.nr.715/2024

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike të paditëses L. K., nga J., të cilën me autorizim e përfaqëson B. Sh., avokat në P., kundër të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Junik, të cilën me autorizim e përfaqësojnë N.S., F.L. dhe S.B., avokatë në P., si dhe juristet A. A, dhe U. R., për kompensimin të pagës mbi bazën e inflacionit, jashtë shqyrtimit, me datë 10.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja jashtëgjyqësore Nd.nr.980/2024, e datës 02.10.2024 lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan, në mes të paditëses L. K. e përfaqësuar nga B. Sh., avokat në P. dhe të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, e përfaqësuar nga N. S., avokat në P., në çështjen juridike kontestimore për kompensimin të pagës mbi bazën e inflacionit dhe e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.980/2024 e datës 02.10.2024.

A r s y e t i m

Gjykata, jashtë seance, me datë 01.10.2024 e ka iniciuar procedurën e ndërmjetësimit dhe ka referuar lëndën në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan për veprime të mëtejme, e cila është regjistruar me numrin e referencës së ndërmjetësimit Nd.nr.980/2024.

Qendra për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan, me datë 09.12.2024 e ka njoftuar gjykatën se pasi që palët vullnetarisht janë pajtuar që të fillojnë procedurën e ndërmjetësimit, të njëjtat kanë arritur që kontestin lëndor të e zgjidhin me marrëveshje jashtëgjyqësore në Qendrën e Ndërmjetësimit ashtu që gjykatës ia ka dorëzuar ekzemplarën e marrëveshjes për zgjidhjen e kësaj çështje sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së palëve në procedurë të arritur me ndërmjetësim, ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3 par. 3.3 dhe nenit 411 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 4, 5, 11, 12, 14, 15 par. 1 dhe nenit 17 të Ligjit për Ndërmjetësimin erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.715/2024, datë 10.12.2024

Gj y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.